



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1-7/2021 regjistri (JD)
Datë. 25.01.2022

Nr. 2 i vendimit
Datë 03.10.2022

**VENDIM
I KOLEGJIT TË SHQYRTIMIT PARAPRAK**

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Natasha Mulaj	Gjyqtare
Ina Rama	Gjyqtare

– mori në shqyrtim paraparak, në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, më datë 03.10.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1-7/2021, datë 25.01.2022, që i përket:

KËRKUES: Hasan Roqi.

**SUBJEKT I
INTERESUAR:** Këshilli i Lartë Gjyqësor

OBJEKTI:

- Saktësim i të metave të vendimit nr. 3, datë 20 dhjetor 2021, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
- Plotësim i vendimit nr. 3, datë 20 dhjetor 2021, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
- Sqarim dhe interpretim i vendimit nr. 3, datë 20 dhjetor 2021, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

BAZA LIGJORE: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:* neni 15; neni 17, pikat 1 dhe 2; neni 18, pikat 1, 2 dhe 3; neni 25; neni 37; neni 41, pikat 1 dhe 2; neni 44; neni 122, pikat 1, 2 dhe 3; neni 126; neni 128, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c”; neni 131, pika 1, shkronja “f”; neni 132, pikat 1 dhe 2; neni 134, pika 1, shkronja “i”; neni 137; neni 179, pika 7.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: nenet 3; 6.1; 8.1; 13; 14; 41; Protokolli 1, neni 1; Protokolli 16, neni 1.

Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar: neni 1, pikat 1 dhe 2; neni 16; neni 25, pika 1; neni 26, pikat 1, 2 dhe 3; neni 31/c, pikat 1 dhe 2; neni 34, shkronja "c"; neni 38, pika 6; neni 42, pikat 1, 2 dhe 3; neni 44/b, pikat 1 dhe 2; neni 45, pikat 1 dhe 2; neni 48, pika 1; neni 49, pika 3, shkronja "e", pika 4; neni 50, pika 4; neni 51, pika 1, shkronjat "a" dhe "b"; neni 54, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 55; neni 71, pikat 1, 2 dhe 3; neni 71/a, pika 1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç"; neni 71/b, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 72, pika 7; neni 76, pikat 1, 2 dhe 3; neni 80, pika 1; neni 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 86, pika 1.

Kodi i Procedurës Civile: nenet 312, 313, 314 dhe 451/a.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Hasan Roqi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit me kërkesë, regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 7/2021, datë 15.10.2021, me objekt:
*1. Konstatimi i pavlefshmërisë së lënies në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi, nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës në Këshillin e Lartë Gjyqësor të vendimit nr. {***} datë 26.05.2021, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me magjistratin A. V., në kuadër të përkrahjes së pandëshkueshmërisë, mungesës së transparencës, ndikimit politik dhe korrupsionit, në cenim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së RSH, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe vendimit 76/2000 të saj, Kodit të Procedurës Civile, ligjet e veçanta, ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së drejtësisë", ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, interesave ligjorë, shëndetësorë, moralë e financiarë të ankuesit dhe familjarëve të tij.*
2. Vendosja para përgjegjësisë disiplinore e subjekteve të interesuara, mbrojtës të veprimtarisë së paligjshme të kandidatit për KLGJ, magjistratit A. V., dhe masa disiplinore edhe për këtë magjistrat. Vendosje e masës së ndalimit të tri pagave mujore për llogari të kërkuesit ndaj tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për mosrespektim të Kushtetutës së RSH dhe KEDNJ, në përkrahje të hapur të shkeljes së tyre, veprime të cilat kanë

sjellë viktimizimin e familjes R., duke rritur më tej stresin, për mosndëshkueshmëri të krimit në sistemin e drejtësisë dhe tejzgjatjen e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese, në shkelje të sigurisë juridike të ligjit të veçantë, përtej 23 vitesh.

3. Dhënia e garancisë procedurale nga Komisioni i Posaçëm i Apelit, në mbrojtje të ekzekutimit të të drejtave që rrjedhin nga vendimi 76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit të veçantë, pikës 9, germa "ç" e udhëzimit të KM nr. 3, datë 21.06.1993, për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit të saj nr. 76/2000 dhe, për shkak të zgjatjes së këtij afati prej 23 vjetësh të mosekzekutimit, por të dhunimit nga autoriteti shtetëror dhe gjykatat e ligjit, të paguajë dëmshpërblimin 100.000 lekë për çdo vit vonesë.

*4. Shpërblimi i dëmit financiar dhe moral për 4 vite nga ana e kandidatit për KLGj, magjistratit A. V., nga dita e dhënies së vendimit të tij nr. {***}, datë 13 shtator 2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në shumën 28.600 euro për dëmin material dhe 30.000 euro për dëmin moral.*

*5. Publikimi në median publike dhe në Shkollën e Magjistraturës si kazus, të vendimit të korruptuar dhe kriminal nr. {***}, datë 13 shtator 2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të grabitjes së hapur të qytetarit, në shkelje flagrante të ligjit dhe Kushtetutës së RSH dhe vendimit 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, në shpërdorim të detyrës në bashkëpunim me krimin e organizuar nga lektori i magjistraturës A. V., dekretuar anëtar i Gjykatës së Lartë mbas vendimit të arkivuar me dashakeqësi ligjore, nga ILD dhe KLGj dhe sot kandidat për KLGj.*

2. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, me vendimin nr. 3, datë 20.12.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
3. Kërkuesi Hasan Roqi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit me kërkesën e regjistruar me nr. prot. {***}, datë 25.01.2022, duke kërkuar saktësimin, plotësimin, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 3, datë 20.12.2021, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak.

II. Pretendimet e kërkuesit

4. Në kërkesën drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kërkuesi ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:
 - a. Në vendimin e Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak që mban nr. 3, gjykata nuk ka vendosur të plotë bazën ligjore të kërkesës, e cila përbën shkakun për të cilin kërkuesi i është drejtuar për zgjidhje gjykatës. Dispozitat e vendosura në kërkesë, nuk janë të përgjithshme, por i referohen me saktësi legjislacionit përkatës. Duke mos vendosur të plotë bazën ligjore të kërkuesit, gjykata i lë shteg ndryshimit të trajtimit të çështjes, duke e sjellë atë jashtë së vërtetës dhe fakteve, duke mos përmendur arsyet themelore përse i është drejtuar gjykatës.
 - b. Në rubrikën "Rrethanat e çështjes", gjykata nuk ka pasqyruar asnjë nga arsyet dhe rrethanat e vërteta që kanë çuar kërkuesin të shtrojë para gjykatës pretendimet e tij për një proces disiplinor të shkeljes flagrante të Kushtetutës, KEDNj-së, ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjeve të tjera nga subjektet e interesuara të çështjes, përkatësisht vendimmarrjet e magjistratit A. V. dhe magjistratët mbrojtës të tij në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të pasqyruara në kërkesën e kërkuesit të datës 27.09.2021.

c. Në rubrikën “Pretendimet e kërkuessit” [paragrafi 2.2 i vendimit], nuk është pasqyruar që kërkuessi ka kërkuar zbatimin e nenit 81, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000 nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndaj magjistratit A. V..

ç. Gjykata nuk ka pasqyruar në vendimin e saj aktet që e detyruan kërkuessin t’i drejtohej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me vendimin nr. {***}, datë 8.10.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuessit i është njohur investimi në banesën ku banonte, në masën 37%. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. {***}, datë 26.03.1998, dhe nga vendimi nr. {***}, datë 8.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese.

d. Nuk është pasqyruar në vendim fakti se udhëzimi i Këshillit të Ministrave për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, kërkonte që pagesa nga ish-pronari të bëhej brenda viti, në të kundërt fitoheshin të drejta bashkëpronësie. Gjithashtu nuk është pasqyruar fakti se prona u regjistrua në emër të ish-pronarit fiktiv, si dhe fakti se kërkuessi i është drejtuar gjykatës me padi për njohjen si bashkëpronar. Me vendimin nr. 6868, datë 21.09.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtari I. H., rrëzoi kërkesën duke argumentuar se pagesa e bërë pas 11,5 vitesh konsiderohej e kryer brenda 1 viti.

dh. Në vendim nuk është pasqyruar fakti se kërkuessi i është drejtuar Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për të monitoruar procesin e vendimmarrjes së vendimit nr. {***}, datë 13.09.2017, me të cilin u vendos mospranimi i përjashtimit nga gjykimi të gjyqtarit F. I.

e. Vendimi i KLGj-së është në shkelje të rënda procedurale pasi kërkuessi nuk është njoftuar për përbërjen e Komisionit Disiplinor, si dhe nuk është njoftuar për seancën për të paraqitur parashtrime apo për të marrë prapësime nga ana e ILD-së.

ë. Në vendimin nr. 3, datë 20.12.2021, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak, duhej të pasqyrohej faktin se kërkuessi, më datë 5.11.2021, i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pas marrjes dijeni për vendimin e KLGj-së, duke paraqitur para Kolegjit vendimin origjinal të KLGj-së. Shprehja “plotësim kërkesë” e kërkuessit dhe paraqitja e vendimit origjinal rrëzon pretendimin e Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak se po shqyrton një kërkesë pa objekt kundërshtimi. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, sipas kërkuessit, duhet të gjykonte vendimin e KLGj-së pasi nuk ka asnjë pengesë ligjore apo kushtetuese.

f. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak ka arsyetuar se, bazuar në nenin 6 të ligjit 115/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të fillojë procedimin disiplinor ndaj anëtarëve të KLGj-së vetëm pas një vendimi të ILD-së. Sipas kërkuessit, duke qenë se Gjykata Kushtetuese është interpreti përfundimtar i çdo lloj legjislacioni, nuk ka vend shpallja e moskompetencës nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar dhe në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës që urdhëron Kolegjin e Posaçëm të Apelimit të gjykojë vendimmarrjen e ILD-së dhe KLGj-së.

g. Sipas kërkuessit, Gjykata Kushtetuese ka detyrimin e ekzekutimit të vendimeve të saj, dhe është detyrë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të sqarojë dhe të interpretojë se cilat dispozita duhet të zbatohen në rastin e shkeljes së vendimit nr. 76, datë 8.11.2000, të Gjykatës Kushtetuese dhe të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nga magjistrati A. V., nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

gj. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak nuk është shprehur nëse vendimi nr. {***}, datë 26.05.2021, i ILD-së dhe vendimi nr. {***}, datë 27.10.2021, i Këshillit të Lartë Gjyqësor janë në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5. Kërkuesi e quan të pabazuar mospranimin nga Kolegji për Shqyrtimin Paraprak të kërkesës për shpërblimin e dëmit nga ana e magjistratit dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor në favor të familjes së kërkuetit.

III. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

6. Kolegji sjell në vëmendje që pas shpalljes, vendimi i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak objekt kërkimi – me nr. 3, datë 20.12.2021 – nuk mund të anulohet ose të ndryshohet. Në mënyrë përjashtimore, një vendim mund të saktësohet ose plotësohet kur ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto kushte, në këtë vendim shtjellohen kërkimet e kërkuetit, të cilat marrin në analizë nëse ekzistojnë rrethanat për saktësimin dhe plotësimin e vendimit objekt kërkese.
7. Së pari, trupi gjykues vëren se pretendimi i kërkuetit se *gjykata nuk ka vendosur të plotë bazën ligjore të kërkesës, është i pabazuar*. Vendimi objekt kërkese [nr. 3, datë 20.12.2021] rezulton të ketë pasqyruar në mënyrë të plotë të gjitha kërkimet, sipas objektit përkatës të kërkesës. Këto aspekte gjejnë pasqyrim të shprehur dhe lehtësisht të konstatueshëm në faqen 4, paragrafët 2.1 - 2.4 të vendimit. Për sa i përket bazës ligjore, Kolegji ka referuar parashikimet ligjore që kanë lidhje me shqyrtimin e kërkesës brenda juridiksionit të tij, duke mbajtur në konsideratë që mënyra e zbatimit të ligjit nga Kolegji, nuk është e lidhur me bazën ligjore që kërkuesi ka vendosur në kërkesë. Si në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ashtu dhe në Kodin e Procedurës Civile, nuk ka asnjë parashikim ligjor që e detyron gjykatën që në pjesën hyrëse të vendimit të saj, të tregojë bazën ligjore të përcaktuar nga kërkuesi, si një element të detyrueshëm të vendimit. Në këto kushte, nuk rezulton që Kolegji të ketë kryer gabime në shkrimin e vendimit.
8. Së dyti, trupi gjykues vëren që po ashtu nuk qëndron pretendimi i kërkuetit se në rubrikën e numërtuar I, “Rrethanat e çështjes”, gjykata nuk ka pasqyruar *asnjë nga arsyet dhe rrethanat e vërteta që kanë çuar kërkuetin të shtrojë para gjykatës pretendimet e tij për proces disiplinor të shkeljes flagrante të Kushtetutës dhe ligjeve të tjera nga subjektet e interesuara të çështjes*. Në rubrikën në fjalë, konkretisht në faqen 3 të vendimit nr. 3, datë 20.12.2021, të Kolegjit, janë cituar në mënyrë të përmbledhur rrethanat dhe kërkimet referuar kërkesës së drejtuar Kolegjit. Në këto kushte, nuk rezulton që nga ana e Kolegjit të jetë bërë ndonjë gabim në shkrimin e vendimit.
9. Së treti, trupi gjykues vëren që edhe pretendimi i kërkuetit se në rubrikën e numërtuar II, “Pretendimet e kërkuetit”, paragrafi 2.2, *duhet rregulluar*, meqenëse është kërkuar zbatimi i nenit 81, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000 nga *Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndaj magjistratit A. V.*, nuk është i bazuar. Kolegji sjell në vëmendje që në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuetit”, faqja 4 e vendimit nr. 3, datë 20.12.2021, janë cituar në mënyrë të përmbledhur kërkesat dhe

pretendimet e kërkuessit. Në këto kushte, nuk rezulton që nga ana e Kolegjit të jetë bërë ndonjë gabim në shkrimin e vendimit.

10. Në përfundim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa e kërkuessit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit të Kolegjit që mban nr. 3/2021, datë 20.12.2021, nuk u provua se bazohet në ekzistencën e ndonjë gabimi në shkrim ose ndonjë pasaktësie të dukshme. Përkundrazi, kërkesa rezulton se bazohet në pretendime dhe kërkime për të ndryshuar *thelbin* e vendimmarrjes së Kolegjit, në kundërshtim me nenet 75 dhe 76, pika 1 dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkesa është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenet 31 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuessit Hasan Roqi.

Tiranë, më 03.10.2022

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi